

DANILO CLEMENTONI

# *RIKTHIM NË TOKË*



*AVENTURAT E  
AZAKISIT DHE PETRIT*



# Përmbajtja

Parathënie

Anija kozmike Theos – 1.000.000 Km nga Jupiteri

Planeti Tokë – Tell el-Mukayyar – Irak

Anija kozmike Theos – Orbita e Jupiterit

Nasiria – Hoteli

Anija kozmike Theos – Alarm i afërsisë

Nasiria – Restoranti Masgouf

Anija kozmike Theos – Objekti misterioz

Nasiria – Darka

Anija kozmike Theos – Analiza e të dhënave

Nasiria – Pas darke

Anija kozmike Theos – Të Moshuarit

Nasiria – Rizgjimi

Anija kozmike Theos – Imazhet nga Toka

Tell el-Mukayyar – Gërmimet

Anija kozmike Theos – Zbulimi i tmerrshëm

Tell el-Mukayyar – Sarkofagu

Anija kozmike Theos – Zona e asteroideve

Tell el-Mukayyar – Inkursioni gjatë natës

Anija kozmike Theos – Pamja mbi Mars

Tell el-Mukayyar – Surpriza e natës

Anija kozmike Theos – Orbita e Tokës

Tell el-Mukayyar – Demaskimi

Anija kozmike Theos – Përgatitjet finale

Tell el-Mukayyar – Katër rojtarët flakërues

Tell el-Mukayyar – Kontakti

Tell el-Mukayyar – Rimarrja

Anija kozmike Theos – Mysafirë në bord

Anija kozmike Theos – Rrëfimi

Referencat bibliografike

*"Po ktheheshim. Kishte kaluar veç një vit i ynë diellor që prej kohës kur kishim qenë të detyruar të braktisnim në nxitim e sipër planetin por për ta, në vite tokësorë kishin kaluar 3.600. Çfarë do të gjenim?"*

## Parathënie

Planeti i dymbëdhjetë, *Nibiru* (planeti i pasazhit) siç u quajt kështu nga Sumerët ose *Marduku* (mbreti i qiejve) siç u ripagëzua nga Babilonasit, është në realitet një trup qiellor që rrotullohet rreth diellit tonë në një periudhë prej 3.600 vitesh. Orbita e tij është mjaft eliptike, retrograde (rrotullohet rreth diellit në kah të kundërt nga të gjithë planetët e tjerë) dhe është shumë e pjerrët në rrafshin e sistemit tonë diellor.

Secili nga afrimet e tij ciklike ka shkaktuar pothuaj gjithmonë tronditje shumë të mëdha ndërplanetare në sistemin tonë diellor si tek orbitat, ashtu edhe tek struktura e planetëve të cilët ishin pjesë e tij. Veçanërisht, shumë kohë përpara, pikërisht në një prej disa kalimeve të tij më të potershme, planeti madhështor *Tiamat*, i ndodhur mes Marsit dhe Jupiterit, me një masë rreth nëntëfish nga ajo e Tokës, i pasur në ujë dhe i përbërë nga njëmbëdhjetë satelitë, u shkatërrua nga një përplasje legjendare. Një nga shtatë hënat orbitale të *Nibirut* goditi *Tiamatin* gjigand duke e thyer në dysh dhe duke i detyruar të dy trupat të zhvendosen mbi orbita të ndryshme. Në kalimin tjetër (“dita e dytë e krijimit” në Bibël), satelitët e mbetur të *Nibirut* e çuan punën gjer në fund, duke shkatërruar plotësisht një nga dy pjesët e formuara gjatë goditjes së parë. Mbetjet që dolën nga përplasjet e shumëfishta krijuan deri diku atë që sot e njohim si “brezi i asteroideve” apo “Krahthi i Dërrmuar” siç ishte quajtur kështu nga Sumerët dhe që u përpinë njëfarësoj nga planetet e afërt. Në mënyrë të veçantë, Jupiteri kohë përpara arriti të kapte shumicën e mbetjeve, duke rritur kështu masën e vet në mënyrë të konsiderueshme.

Satelitët shkaktarë të katastrofës, përshirë ata të mbijetuar nga *ish-Tiamati*, kryesisht “u degdisën larg” mbi orbitat e jashtme, duke formuar ato që sot i quajmë si “kometa”. Ndërsa pjesa që shpëtoi gjatë kalimit të dytë u vendos në një orbitë stabël midis Marsit dhe Venusit, duke e zhvendosur mbrapa satelitin e fundit të mbetur dhe duke shkuar kështu drejt formimit të asaj që ne sot e njohim si Toka, së bashku me shoqen e saj të pandashme Hënë.

Shenja e shkaktuar nga ai impakt kozmik, që ndodhi rreth 4 miliardë vite më përpara, është akoma edhe sot deri diku i dukshëm. Pjesa e çjerrë e planetit aktualisht është krejtësisht e mbuluar nga ato ujëra që sot përbëjnë Oqeanin Paqësor. Ai zë rreth një të tretën e sipërfaqes së tokës me një shtrirje prej më shumë se 179 milionë kilometra katrorë. Në tërë këtë sipërfaqe të pafundme praktikisht nuk ka prezencë të tokave mbi nivelin e

detit, por vetëm një gropë të madhe që shtrihet deri në thellësi që i kalon dhjetë kilometrat.

Aktualisht *Nibiru*, si konstrukt, është shumë i ngjashëm me Tokën. Në dy të tretat e tij është i mbuluar nga uji, ndërkohë që pjesa tjetër përbëhet nga një kontinent i vetëm që shtrihet nga veriu në jug, me një sipërfaqe të përgjithshme mbi 100 milionë kilometra katrorë. Disa nga banorët e tij, prej qindra deri mijëra vitesh, duke përfituar nga afrimi ciklik i planetit të tyre me tonin, kanë bërë vizita në mënyrë sistematike, duke ndikuar çdo herë në kulturën, dijet, teknologjinë dhe madje në vetë evolucionin e racës njerëzore. Paraardhësit tanë i kanë quajtur në shumë mënyra, por ndoshta emri që i personifikon ata më tepër është “*Zotal*”.

## Anija kozmike Theos – 1.000.000 Km nga Jupiteri

Azakisi ishte shtrirë rehatshëm sa gjatë e gjerë në kolltukun e tij të errët dhe të vetëmykur, të cilin një mik i vjetër *Artizan* që e kishte bërë me duart e veta, kishte dashur t'ia dhuronte atij vite më parë me rastin e misionit të tij të parë ndërplanetar. “Ty do të të sjellë fat,” i kishte thënë atij atë ditë. “Do të të ndihmojë që të çlodhesh dhe të marrësh vendimet e duhura kur të kesh nevojë. Dhe në fakt, i ulur aty, ai kishte marrë disa vendime që atëherë dhe fati kishte qenë shpesh në anën e tij. Dhe kështu kishte bërë gjithmonë duke e mbajtur me vete atë kujtim të shtrenjtë, pavarësisht shumë prej rregullave që do ta pengonin ta përdorte, sidomos në një anije kozmike të tipit Bousen-1 si ajo ku gjendej tani.

Një shtëllungë e hollë tymi në nuancë blu u ngrit shpejt dhe pingulthi nga cigarja që mbante midis dy gishtave të parë të dorës së djathtë, ndërkohë që me vështrimin ngultas, përpiquej të ndiqte 4,2 *UA*<sup>1</sup> që akoma e ndante atë nga vendmbërritja. Megjithëse kishte tashmë disa vite që ndërmernte të tilla udhëtime, magjia e errësirës që e rrethonte bashkë me mijëra yjet që e pikëlonin, ishin ende në gjendje të rroknin mendimet e tij. Vrima e madhe në formë vezake i lejonte një pamje të plotë në drejtim të udhëtimit, dhe ai gjithmonë ngelej i habitur sesi ajo forcë tepër e lehtë e fushës vektoriale ishte në gjendje ta mbronte nga i ftohti yjësor i hapësirës, të pengonte ajrin të dilte jashtë krejt papritur, i përpirë nga zbrazëtira e plotë e kozmosit. Vdekja do të ishte pothuajse e menjëhershme.

I futi një të thithur të shpejtë cigares së gjatë dhe vazhdoi të sodiste pamjen holografike drejt përpara, në të cilën shfaqej fytyra e lodhur dhe e parruar e shokut të tij të udhëtimit, që në anën tjetër të anijes, po riparonte sistemin e kontrollit të tubave të shkarkimit. U argëtua paksa tek shtrembëronte imazhin duke fryrë në mes tymin që sapo kishte thithur, duke krijuar kështu një efekt valëzues që aq shumë i kujtonte lëvizjet e lakuara të kërcimtareve sensuale, të cilat kishte vajtur shpesh t'i shihte kur kthehej më në fund në shtëpi dhe kur mundej t'i gëzohej sadopak një çlodhjeje të merituar.

Petri, miku dhe shoku i tij i aventurës, tashmë ishte afro tridhjetë e dy vjeç dhe ky ishte misioni i tij i katërt i këtij lloji.

Busti i tij i fortë dhe imponues gjithmonë ngjallte shumë respekt tek të gjithë ata që takonte. Sy të zinj si hapësira kozmike, flokë të errët, të gjatë e të çrregullt që i arrinin deri tek shpatullat, i gjatë pothuajse dy metra e tridhjetë, kraharori dhe krahu i tij mund të ngrinin pa mundim një *Nebir*<sup>2</sup> të

**You've Just Finished your Free Sample**

**Enjoyed the preview?**

**Buy: <http://www.ebooks2go.com>**